

KOMUNA RAHOVEC

BULETINI MUJOR KOMUNAL
NËNTOR 2022



PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE.....	3
PËRFUNDIM.....	123

HYRJE

Ky buletin është krijuar me idenë e promovimit të aktivitetave të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtoreve përgjatë muajve të vitit 2022.

Rrëndësia e botimit të buletinit mujor qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktivitetave të Komunës së Rahovecit, në mënyrë të tillë që t'i mundësojmë qytetarit të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

Muaji nëntor i vitit 2022, është karakterizuar me një sërë aktivitetesh të kryetarit dhe drejtorëve të drejtoreve.

Me anë të këtij buletini mujor për muajin nëntor, ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktivitetet e Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtoreve në Komunën e Rahovecit.

AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE



Pas nënshkrimit të kontratës dhe pas të gjitha përgatitjeve që u bënë, në prani të nxënësve, mësimdhënësve, drejtorit të arsimit dhe shumë qytetarëve të Xerxës, ka nisur së zbatuar projekti për ndërtimin e objektit të ri të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët "Hamëz Thaçi". Vënia e gurthemelit, që simbolizon nisjen e punimeve është rezultat i angazhimit dhe përkushtimit tonë për të realizuar investime, që janë në funksion të ofrimit të kushteve dhe standardeve sa më bashkëkohore për mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore. Objekti i ri i shkollës, përvèç se do të ketë lidhje fizike me objektin ekzistues, do të ketë edhe kabinete, bibliotekë dhe sallën moderne të edukatës fizike.

Kryetari Latifi, së bashku me drejtoreshën për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale Saranda Salltekun, kanë nënshkruar kontratat përkrahje financiare të projekteve të SHPG "Hareja" dhe të OJQ "Handikos".



Kryetari Latifi, së bashku me drejtorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Berat Durakun, si dhe me stafin e tij, vunë gurthemelin për fillimin e punimeve në projektin për "Ndërtimin e Qendrës për Magazinimin dhe Ruajtjen e Prodhimeve Bujqësore (Deposë Bujqësore)". Kjo depo do të ketë 7 dhoma ftohëse, ku 3 prej tyre dojenë edhe me ngrirje të thellë dhe energjia për to do të sigurohet edhe nga panelet diellore. Projekti kap vlerë 1% prej 424,397.00 €.

Në 24 vjetorin e rënies në përballje me forcat pushtuese serbe, kryetari Smajl Latifi, së bashku me stafin e tij bënë homazhe në nderim të kujtimit dhe vdeprës së pavdekshme ndër breza të heronje Xhelal Hajda - Toni, Selajdin Mullaçazi - Mici nga Rahoveci, si dhe Hamdi Hajrizi, Bektesh Haliti dhe Nezir Ymeri nga Vushtrria.



Drejtori i DBPZHR - së, z. Berat Duraku i shoqëruar nga veterinari i angazhuar nga komuna e Rahovecit dhe zyrtarë të BPZHR - së, kanë filluar vizitat te fermerët tanë blegtore, për t'i hapur kështu rrugë parandalimit të sëmundjeve përmes vaksinimit nëpërmjet ofrimit të vizitave për Shërbime veterinare periodike falas. Vizitat do të realizohen në baza periodike në tërë territorin e komunës së Rahovecit, ku përmes këtij shërbimi do arrijmë të jemi më afër fermerëve blegtore të komunës sonë.



Sot gjatë ditës, vizituam punimet e pastrimit të shtratit të lumit nga Krushë e Madhe deri te Drini i Bardhë. Pastrimi i shtratit të lumit do të mundësojë shkarkimin më të lehtë të ujërave në Driinin e Bardhë dhe do të evitojë përmbytjet në këtë zonë.

Në sallën e Kuvendit Komunal, në shoqërimin e drejtorëve të drejtorive, kryetari Smajl Latifi, mbajti takimin e rregullt periodik me punonjësit e administratës. Kryetari kërkoi nga ata që të respektojnë orarin e punës, dhe meqë dimri është në prag, të mundohemi bashkërisht të i ulim sa më shumë shpenzimet e energjisë elektrike si dhe t'i përdorim sa më përgjegjshëm lëndët djegëse. Në fund, ai i falënderoi të gjithë punonjësit për angazhimin e parezervë në ofrimin e shërbimeve cilësore komunale, por, gjithmonë duke synuar që të bëjmë më të mirën e mundshme.



Në prani të familjarëve, bashkëluftëtarëve e miqve, kryetari Latifi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, përkujtuan dëshmorin e lirisë, Lulzim Shaip Hoti nga Ratkoci. Luli ishte i organizuar në Lëvizjen Kombëtare për Çlirimin e Kosovës, duke qenë njëri ndër bartësit e veprimitarisë së fshehtë atdhetare në Anadrini, poashtu ndër djemtë që ka strehuar dhe furnizuar me armatime e municione luftëni çlirimitare, e si luftëtar i UÇK-së, u plagos rëndë në betejën e 12 majit 1998, ku si pasojë e këtyre plagëve, u pavdekësua në kujtesën e brezave, pas çlirimtimit, më 9 nëntor 2005.



Drejtoria për Arsim ka filluar furnizimin e shkollave me tabela digitale, si rezultat i zbatimit të projektit "Furnizimi i shkollave me tabela digitale". Në këtë fazë do t'i furnizojmë 20 shkolla me nga një tabelë të tillë dhe këtë projekt do ta vazhdojmë edhe vitin e ardhshëm. Me anë të tabelave digitale synohet të bëhet një hap përpara në digjitalizimin e shkollave, në mënyrë që nxënësit tanë ta kenë më të lehtë përvetësimin e njohurive në të gjitha lëndët mësimore. Ky projekt është i financuar nga komuna jonë, i cili do të ndikojë drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë në arsim.





Kryetari i komunës ka nënshkruar edhe një kontratë shumë të rëndësishme për arsimin në komunën tonë, për projektin "Ndërtimi i aneksit të SHFMU "KATËR DËSHMORËT" në Ratkoc". Me ndërtimin e këtij aneksi shkollor, i cili do të përmbajë në vete 14 dhoma mësimi (klasa), sallën e arsimtarëve dhe hapësirat tjera, do të bëhet e mundshme që nxënësit e kësaj shkolle të mbajnë mësim në një ndërrim të vetëm. Vlera e projektit është 899.991,89 €.

Drejtoria e Shërbimeve Publike ka njoftuar se janë duke vazduar punimet në ndërtimin e rrugëve lokale në komunën e Rahovecit.



Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka njoftuar se janë duke vazduar punimet në ndërtimin e kanalit të kullimit të tokave bujqësore në fshatin Fortesë. Janë vendosur gypat për drenazhim në katër segmente, të cilët do të ndihmojnë në ruajtjen e mbi 200 ha të tokave bujqësore në këtë zone.

Kryetari Latifi ka vizituar nga afér punimet që po zhvillohen në shtrimin e asfaltit në vazhdimin e rrugës me 4 korsi, në rregullimin e kanalizimit dhe punëve të tjera, e në rrugën tranzite, atë të UÇK-së, që është pjesë e këtij projekti të madh.



Kryetari i Komunës, z. Smajl Latifi, ka pritur në takim pune, Drejtorin e KRU "Radoniqi - Dukagjini", z. Jahja Kadrija së bashku me përfaqësues të projektit të ARDP- së, të financuar përmes kredisë nga Banka Botërore dhe zbatohet nga MBPZhR, znj. Arlinda Arenliu, drejtoreshë e projektit, z. Avdullah Nishori, specialist i ujitjes, znj. Laura Gjakova - ARDP dhe z. Bali Lestrani - MBPZHR, të cilët paraqitën planin e investimeve përfazën e dytë në sistemin aktual të ujitjes, e tëra kjo me qëllim të përgatitjes përfazën e zgjerimit të sistemit të ujitjes edhe në vendbanime dhe zona që nuk janë të përfshira në sistemin ekzistues të ujitjes. Investimi do të kap vlerën gjithsej 10 milionë €, pra, projekti është vazhdimësi e shumës 4.2 milionë €, e filluar vite më parë. Projekti parashihet të zbatohet deri në vitin 2026, ku do të përfshihen punime në rregullimin e kanalit të ujitjes, do të bëhet vendosja e 165 valvulave (hidromatës) të cilat do të masin sasinë e ujit të shpenzuar, kontrollimin e presionit të ujit, vendosjen e sistemit të kontrollimit të centralizuar të menaxhimit dhe defekteve në rrjete, modernizimin e rrjetit ekzistues me qëllim të përballimit të kapacitetit të zgjerimit në fazat e tjera.





Organizuar nga DKA, është mbajtur Gara Komunale e Olimpiadës Matematike ndërmjet nxënësve të klasave 9, 10, 11 dhe 12. Pjesëmarrës në garë ishin nxënësit më të mirë nga lënda e matematikës nga të gjitha shkollat e komunës sonë. Më të mirët e kësaj gare do ta përfaqësojnë komunën tonë në Garën Republikane të Olimpiadës Matematike.



Drejtoria Komunale për Arsim në komunën e Rahovecit, ka filluar furnizimin me inventar për objektin e të shkollës në Retijë. Së shpejti do të bëhet përrim i kësaj shkolle të re, projekt ky i financuar dhe i realizuar nga komuna e Rahovecit.

Në prag të 28 Nëntorit, u përruua fusha sportive në oborrin e Shkollës së Mesme të Lartë "12 Maji" në Ratkoc. Në ceremoninë e përrimit ishin të pranishëm kryetari i komunës Smajl Latifi, nënkyetari Fatmir Iska, drejtori i arsimit Avni Morina, kryetari i Këshillit të fshatit Beqë Shala, drejtori i shkollës Hasan Krasniqi, mësimdhënësit, nxënësit dhe qytetarë të shumtë. Rregullimi i kësaj fushe sportive u bë me bashkëfinancim të komunës sonë dhe Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK). Kësaj fushe sportive përvèç se iu bë drenazhimi i duhur, ajo u shtrua edhe me bar sintetik, duke u bërë një fushë sportive me standarde të larta bashkëkohore.

Kryetari Latifi, në prani të bashkëpunëtorëve të tij, në prani të SHL – Kosova, LMT-së si dhe qytetarëve prezentë, ka bërë prezantimin e projektit Harta Turistike e Rahovecit dhe Harta e Trashëgimisë Kulturore me QR CODE "RAHOVECI DIGITAL", i cili është projekti i radhës i zhvilluar nga Komuna e Rahovecit, tejet i nevojshëm për orientimin e vizitorëve të huaj në Rahovec dhe mundësi e promovimit të potentialit tonë turistik, të trashëgimisë kulturore dhe historike dhe vlerave të tjera, si dhe një hap i rëndësishëm për planifikimet e ardhshme në këto lëmi. Në hartë janë të përfshira 108 objekte të propozuara nga Komuna e Rahovecit të ndara në:

- Atraksionet turistike, monumentet e trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore, me 46 objekte;
- Akomodim dhe Gastronomi me 31 objekte;
- Veraritë dhe Bodrumet me 17 objekte;
- Dyqanet dhe pikat e tjera me 14 objekte.



Në vigjilje të festave kombëtare të Nëntorit e në praninë e drejtuesve të OVL të UÇK-së, kryetari Latifi përuroi dy pllaka përkujtimore në Kramovik, përkatësisht, në shtëpitë e Musli Avdullah Kelmendit dhe të Gani Shaban Kelmendit, ku nga 14 qershor 1998 e për disa muaj rresht ishin pika të zjarrit të UÇK-së, e me këtë rast, kryetari shprehu mirënjojen dhe respektin e familjeve të tyre, lagjes Kelmendi, luftëtarëve të UÇK-së nga Kramoviku dhe gjithë pjesëmarrësve në këtë betejë.





Kryetari Latifi ka nënshkruar kontratën përrregullimin e infrastrukturës publike, respektivisht ndërtimin e disa rrugëve me elementet përcjellëse në qytet, në vlerë prej 1,222,222.00 €, e cila kontratë është në bashkëfinancim mes MMPhi-së dhe Komunës së Rahovecit, ku përfshihet ndërtimi i rrugëve: Ali Sokoli; Fahredin Hoxha; Dëshmorët e Pashtrikut; Xhelal Hajda - Toni; Gzim Hamza - Piktori dhe Shejh Mihedini. Këto rrugë do të trajtohen me infrastrukturë publike nëntokësore, kanalizim fekal dhe atmosferik, kabllo nëntokësore aty ku mungojnë, trotuare, ndriçim publik, asfaltim të tërësishëm si dhe kanale për trajtim të ujut dhe devijimi i lumit Duhillo (afër Teqesë së Madhe të Halvetive).


Në prag të 28 Nëntorit, në bashkëpunim me OVL të UÇK-së në Rahovec, Kryetari I komunës z. Smajl Latifi, në Krushë të Madhe përuroi 7 pllaka përkujtimore në shtëpitë të cilat gjatë luftës 1998 dhe 1999, ishin strehë e UÇK- së. Mirënjoyje e thellë dhe vlerësim i lartë për kontributin dhe përkrahjen e drejtëpërdrejtë që i kanë dhënë luftës sonë çlirimtare:

- * Familja e Musli Veselit;
- * Familja e Ymer (Haxhi) Dellovës;
- * Familja e Xhevdet Durakut;
- * Familja e Mehmet Behrës;
- * Familja e Liman Gashit;
- * Familja e Avdi Xhafer Durakut dhe
- * Familja e Sejfulla Damon Sejfullahut.



Në prag të 28 Nëntorit - Festës sonë të madhe kombëtare, kryetari Latifi së bashku me bashkëpunëtorët e tij, si dhe në prani të qytetarëve, përuroi objektin e ri të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët "Haki Stërmilli", paralelja e ndarë në Retijë, projekt ky i financuar dhe i realizuar nga komuna jonë.

Ky objekt shkolle është një objekt të ri, modern, me kushte shumë të mira dhe standarde bashkëkohore për të zhvilluar proces mësimor cilësor.



Në prag të 28 NËNTORIT të lavdishëm, profesor Sabahajdin Cena ka promovuar librin e tij më të ri "KRONIKË NËPËR STUHI" - 2 (prill, maj, qershor), kushtuar të gjithë atyre që me sakrificën dhe vetëflijimin sollën këto ditë lirie. Sabahajdin Cena si pjesëmarrës i drejtëpërdrejt i luftimeve dhe zhvillimeve dramatike të luftës së UÇK-së, në këtë botim ka pasqyruar sistemakisht dhe në mënyrë kronologjike ngjarjet të lavdishme të luftës për liri dhe me profesionalizëm, ka përshkruar detajisht kontributin dhe veprat e çdo dëshmori. Përbledhja e të dhënave jetësore, lufta dhe rëniet e dëshmorëve, të publikuara në katër vëllime "Kronikë nëpër stuhi", mund të konsiderohen si një enciklopedi e llojit të vet.


Në sallën e Kuvendit Komunal, është mbajtur konsultimi publik për Projekt Planin e punës së Kryetarit dhe ekzekutivit për vitin 2023. Shefi i Kabinetit, z. Ali Morina prezantoi në pikë të shkurtëra Projekt Planin, synimet dhe prioritet kryesore të vitit 2023, ku ndër të tjera tha se Komuna e Rahovecit dhe Qeveria Komunale, prezanton planin e saj qeverisës për vitin 2023, duke e bërë një studim të detajuar të të arriturave, por edhe nevojave dhe pritjeve të qytetarëve nga Komuna e Rahovecit për të ardhmen.





Në Sallën e Hotel "Park Plaza" u mbajt konsultimi publik për Planin e Mobilitetit Urban në Komunën e Rahovecit. Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, Përparim Krasniqi, para të pranishmëve e paraqiti planin në pika të shkurtëra.

Me rastin e 28 Nëntorit – Ditës së Pavarësisë së Shqipërisë, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, organizoi aktivitetet kulturore të shumta si dhe koncertin festiv, ku present ishin ansamblet nga Shkupi dhe Krusha e Madhe. Manifestimi është mbajtur në palestrën sportive "Mizahir Isma" në Rahovec.



PËRFUNDIM

Ky buletin përmblehdhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë muajit nëntor 2022.

Fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, e një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendor është liria e informimit.

Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin, porse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij buletini muJOR ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t’iu dhënë mundësi qytetarëve që të njojin dhe vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gjelqojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Rahovec, nëntor 2022